

Nr. 294 Prot  
Dt: 21.03.2017



- 2v / Rrektoreve ✓  
- Dekanëve  
- Prof. të dyp. të Ekonomisë  
21.03.2017  
Nikolla

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 2795 Prot.

Tiranë, më 20.03.2017

**URDHËR**

Nr 126, datë 20.03.2017

**PËR**

**HAPJEN E NJËSISË KRYESORE "FAKULTETI EKONOMIK", TË  
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 30, pika 5 ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e njësisë kryesore "Fakulteti Ekonomik", të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, me strukturën si më poshtë:
  - a) Departamenti Kontabilitet-Financë;
  - b) Departamenti Administrim Publik;
  - c) Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit .
2. Veprimtaria akademike për njësinë kryesore "Fakulteti Ekonomik", fillon në vitin akademik 2017-2018.
3. Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Shpenzimet financiare për hapjen e fakultetit të ri të mbulohen sipas vendimmarrjes së Bordit të Administrimit të këtij Universiteti.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë dhe Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare"

**LINDITA NIKOLLA**

**MINISTËR**

